



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1784/prot.

Pogradec, më 23.09, 2026

12

Lënda:

Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar Zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dokumentacionim justifikues dhe relacionin shoqërues, për:

1. Për rishqyrtimin e tarifave të parkimeve që do të aplikojë shoqëria POGRADECI INVEST SHPK, për vitin 2026.

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy).

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 3 (Tre)

Vendim i Asamblese së Përgjithshme: 1 (Një).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2026

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2026

**PËR
RISHQYRTIMIN E TARIFAVE TË PARKIMEVE QË DO TË APLIKOJË
SHOQËRISË POGRADECI INVEST SHPK, PËR VITIN 2026.**

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës "f" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; neni 35 i Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; shkronja "f" e nenit 7 të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; me propozim të shoqërisë Pogradeci Invest Shpk dhe Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratohen tarifat e parkimeve për vend parkimet publike me pagesë si më poshtë vijon:

1.1 Tarifa e parkimit tek ish – Terminali:

NR	EMËRTESA E TARIFËS	NJËSIA	VLERA E TARIFËS	
			ISHTE	BËHET
1	Tarifa për parkimin e automjeteve në Ish - Terminali	Lekë/orë	50	100

1.2 Tarifa e parkimeve në parkimet publike në pronësi të Bashkisë Pogradec:



NR	EMËRTESA E TARIFËS	NJËSIA	VLERA E TARIFËS			
			ISHTE	BËHET		
1	Tarifa për automjetet në parkimet publike me pagesë, në pronësi të bashkisë Pogradec	Lekë/orë	50	50		
2	Tarifa për automjetet në parkimet publike me pagesë, gjatë sezonit turistik 15 Qershor – 15 Shtator, përgjatë Bulevardit, “Reshit Collaku” dhe “10 Dëshmorët e Pojskës”.	Lekë/orë	50	100		
3	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjektet tregtare pranë biznesit të vet.	Lekë/vit	36 000	8 orë (8:00 - 16:00)	12 orë (8:00 – 20:00)	24 orë (00:00- 24:00)
				36 000	45 000	72000
4	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjektet tregtare me objekt veprimtarie, “Hotel”.	Lekë/ Vit	36 000	72 000		
5	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për banorët pranë shtëpisë së vet.	Lekë/3 muaj	0	9 000		
		Lekë/6 muaj	0	18 000		
		Lekë/12 muaj	0	36 000		
5	Tarifë për parkim për banorët, për parkim të automjetit brenda zonën së vet ku jeton.	Lekë/12 muaj	1000	1000		



2. Të miratohen kërkesat e mëposhtme:

2.1 Aksi i Zonës Industriale, të behet parkim me pagesë deri në momentin e kthimit të këtij aksi me dy kalime.

2.2 Përveç dy zonave të miratuara për parkim 1, dhe 2, të shtohet edhe dy zona të tjera në qytetin e Pogradecit 3, 4 në të cilat të behet vijezimi i parkimeve, vendosja e tabelave dhe të shërbejnë si zona parkimi për rezidentët, sipas hartave bashkëngjitur Vendimit të Këshillit Bashkiak.

3. Efektet: Vendosja e tarifave të parkimit synon rregullimin e fluksit të mjeteve, disiplinimin e përdoruesve të hapësirave publike dhe garantimin e një përdorimi të drejtë dhe efikas të tyre.

4. Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec, dhe Administrata e Shoqërisë, Pogradeci Invest Shpk.

5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

6. U shpall sot më datë __. __. 2026.

**KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI**



POGRADECI INVEST Sh.p.k
ADMINISTRATORI

Nr. 1701 Prot.
112

Pogradec, më 23 07 2026

RELACION

PËR PROJEKT- VENDIMIN ME OBJEKT,

“PËR RISHQYRTIMIN E TARIFAVE TË PARKIMEVE QË DO TË APLIKOJË SHOQËRIA POGRADECI INVEST SHPK, PËR VITIN 2026.

E NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Administrata e shoqërisë Pogradeci Invest Shpk, dhe administratori në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe në zbatim të statutit të shoqërisë, fillimisht kanë paraqitur pranë Asamblesë së Përgjithshme për shqyrtim dhe miratim tarifave që do të aplikojë shoqëria, duke filluar nga data 1 janar 2026, duke parashtruar kërkesat si më poshtë vijon:

1. Në kuadër të administrimit dhe menaxhimit të parkimeve *ne hapësira publike ne pronesi te Bashkise Pogradec*, shoqëria ka mbledhur të ardhura, bazuar tek Vendimi i Këshilli i Bashkisë Pogradec Nr. 133, datë 11.12.2023, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkinë Pogradec”, Kreu II.9 e në vazhdim.

Por, tani administrata e shoqërisë mendon se ka erdhur koha që për shoqërinë, Pogradeci Invest Shpk, ne kuader te paketes fiskale te vitit 2026, të miratohej nje vendim i posacëm nga ana e Asamblesë së Përgjithshme e Shoqërisë dhe Keshillit te Bashkisë Pogradec, duke shfuqizuar pjesërisht dispozitat e vendimit Nr. 113, datë 11.12.2023, te cilat vijne ne kundërshtim me dispozitat e vendimit te ri.

Shënim: Vendimi i Këshilli i Bashkisë Pogradec Nr. 133, datë 11.12.2023, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkinë Pogradec, është ndryshuar disa here, dhe aktualisht është në fuqi.



2. Me hyrjen ne fuqi te vendimit, duke filluar nga data 1 janar 2026, Shoqeria Pogradeci Invest Shpk, synon të sjellë disa risi themelore te cilat janë:

- Cdo banor rezident ne qytetin e Pogradecit, i cili posedon nje prone me qera, pronesi, huaperdorje etj, per nje automjet mund te rezervoje nje parkim të dedikuar pranë baneses ku jeton, per vetem nje makine, dhe ne vend parkimi i tij do te shenohej targa e atumjetit per te cilen ka bere pagese.

Kjo tarife eshte 100 lek/dite, per te pakten 3 muaj.

Me kete tarife minimale per 3 muaj, kekojme te disiplinojme parkimet gjate periudhes se sezonit veror.

- Gjatë sezonit veror, me periudhë të percaktuar, duke filluar data 15 qershor - 15 shtator, me argumentimin e disiplinimit te parkimeve, pergjate Bulevardit, "10 Dëshmorët e Pojskës", duke filluar nga Kapri Center deri tek Restorant – Hotel Perla dhe pergjate Bulevardit, "Reshit Collaku", duke filluar nga Posta deri tek Ish Turizmi i Vjeter, pagesa per nje orë parkimi të behej 100 lek.

3. Për sa më sipër, u hartuan dhe u dorezuan vendimet shoqëruar me dokumentacionin përkatës tek Këshilli i Bashkisë, dhe gjatë mbledhjes nga ana e Këshilltarëve, konstatohet se janë propozuar disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

- *Z. Haxhillari, ka propozuar që Segmenti I Rrugës Industriale, të rikthehej përsëri me dy kalime, sic ka qënë më përpara, dhe jo të shtohen parkime me pagesë.*
- *Znj. Manjola Kamolli, ka kërkuar që të jenë bashkëngjitur harta e zonave 3 dhe 4.*
- *Znj. Topa ka kërkuar rishikimin e politikës së kartës së rezidentit.*
- *Në përgjithësi, të gjithë Këshilltarët diskutues në mbledhje kanë qënë kundër rritjes së tarifës së parkimit për biznesin dhe z. Shtupa ka propozuar që, "Për të shmangur rritjen e madhe, parkimet të mos jenë 24 orëshe, por 8 orëshe ose 12 orëshe, përvec hoteleve, në mënyrë që më pas të shfrytëzohen edhe nga qytetarët".*

Për sa më sipër, ne perputhje me kërkesat dhe rekomandimet e Këshilltarëve, me propozim të Administratës së Shoqërisë Pogradeci Invest Shpk, Asambleja e Pergjithshme mori nje vendim duke reflektuar te gjitha propozimet dhe kerkesat si më poshtë:

1. Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjektet tregtare pranë biznesit të vet, u shtuan tre opsione me 8 orë parkim me vlere 36 000 lek/vit për pesë ditë të javës (e shtunë e djelë ,të ofrohet parkim për qytetarët)dhe 12 ore parkim me vlere 45 000 lek në vit për pesë ditë të javës (e shtunë e djelë ,të ofrohet parkim për qytetarët) ,dhe 24 orë parkim me vlerë 72 000 lekë /vit në 7(shtatë)ditë të javës .



2. U vecua tarifa për parkim të rezervuar automjeti për subjektet tregtare me objekt veprimtarie, "Hotel", me vlere 72 000 lek/vit.
3. Aksi i Zonës Industriale, të behet parkim me pagesë deri në momentin e kthimit të këtij aksi me dy kalime.
4. Përveç dy zonave të miratuara për parkim 1, dhe 2, të shtohet edhe dy zona te tjera në qytetin e Pogradecit 3, 4 në të cilat të behej vijeziimi i parkimeve, vendosja e tabelave dhe të shërbejnë si zona parkimi për rezidentët, sipas hartave bashkëngjitur Vendimit të Këshillit Bashkiak.

Shënim: Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme, shërben vetëm për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë (Referuar dispozitat të Ligjit nr. 9901) dhe i shtrin efektet e veta tregtare dhe financiare pasi të miratohet edhe nga Këshilli i Bashkisë Pogradec, në respektim të shkronjës "P" të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ku sanksion se Këshilli i Bashkisë, vendos për taksat e tarifave vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

PËRFUNDIM:

Në kuadër të kompetencave të Këshillit Bashkiak për administrimin e territorit dhe miratimin e taksave dhe tarifave vendore, paraqitet për shqyrtim dhe miratim relacioni dhe projekt vendimi, me qëllim disiplinimin e parkimit në zonat publike të bashkisë.

Situata aktuale e parkimit në qytetin e Pogradecit, vecanerisht gjate sezonit veror, karakterizohet nga mbingarkesë e hapësirave publike, parkime të parregullta dhe mungesë rotacioni të mjeteve, çka ndikon negativisht në qarkullimin rrugor, sigurinë publike dhe aksesin e qytetarëve në shërbime.

Për këtë arsye, lind nevoja për vendosjen e një sistemi të rregulluar parkimi, të mbështetur në aplikimin e tarifave të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Vendosja e tarifave të parkimit synon rregullimin e fluksit të mjeteve, disiplinimin e përdoruesve të hapësirave publike dhe garantimin e një përdorimi të drejtë dhe efikas të tyre.

Të ardhurat e përfituara nga tarifat e parkimit do të destinohen për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sinjalistikës horizontale dhe vertikale, si dhe për shërbimet e monitorimit dhe administrimit të parkimeve publike.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak të miratojë disiplinimin e parkimit në zonat publike përmes aplikimit të tarifave përkatëse, si masë e domosdoshme për përmirësimin e rendit urban dhe rritjen e cilësisë së jetesës në territorin e bashkisë.



për sa më sipër mendojmë se projektvendimi i ri bashkëngjitur është në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Ju Faleminderit,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi: Aurel Guri

Pranoi: Manuela Jaiçari

Miratoi: ADMINISTRATOR Kledi ÇELA

Konfirmoi: KRYETAR

ILIR XHAKOLLI



POGRADECI INVEST Sh.p.k
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 81 Prot.

Pogradec, më 23.04.2026

VENDIM

NR. 6, DATË 23.04.2026

PËR
RISHQYRTIMIN E TARIFAVE TË PARKIMEVE QË DO TË APLIKOJË
SHOQËRISË POGRADECI INVEST SHPK, PËR VITIN 2026.

Sot më datë 23.04.2026, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë Pogradeci Invest SHPK, e perfaqësuar nga z. Ilir XHAKOLLI, në cilësinë Kryetarit të Bashkisë Pogradec, me 100 % të aksioneve, referuar diskutimeve dhe propozimeve të relatuara nga Këshilli i Bashkisë Pogradec në mbledhjen e datës 25.02.2026, si dhe pasi u njoh me zbardhjen e procesverbalit të kësaj mbledhje, u mbledh në ambjentet e Bashkisë Pogradec, për të zhvilluar mbledhjen e vet me rend dite, si më poshtë vijon:

1. Për rishqyrtimin e tarifave të parkimeve që do të aplikojë shoqërisë POGRADECI INVEST SHPK, për vitin 2026.
2. Për rishqyrtimin e tarifave të administrimit për ndërtesat që do të administrohen nga shoqëria POGRADECI INVEST SHPK.
3. Të tjera.

Duke qënë se në mbledhje është prezent personalisht ortaku i vetëm i shoqërisë, perkatesisht: z. Ilir XHAKOLLI, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plote për të vepruar, pasi u njoh me zbardhjen e procesverbalit të datës 25.02.2026,

KONSTATOHET SE:

Administrata e shoqërisë dhe administratori në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe në zbatim të statutit të shoqërisë, kanë paraqitur pranë Asamblesë së Përgjithshme për shqyrtim dhe miratim tarifave që do të aplikojë shoqëria, duke filluar nga data 1 janar 2026, duke parashtruar kërkesat si më poshtë vijon:

1. Në kuadër të administrimit dhe menaxhimit të parkimeve *ne hapesira publike ne pronesi te Bashkise Pogradec*, shoqëria ka mbledhur të ardhura, bazuar tek Vendimi i Këshilli i Bashkisë Pogradec Nr. 133, datë 11.12.2023, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec", Kreu II.9 e në vazhdim.

Administrata e shoqërisë vlerëson se ka erdhur koha që për shoqërinë, Pogradec Invest ShtpK, në kuadër të paketës fiskale të vitit 2026, të miratohet një vendim i posaçëm nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe Këshilli të Bashkisë Pogradec, duke ndryshuar pjesërisht dispozitat e vendimit Nr. 113, datë 11.12.2023, të cilat vijnë në kundërshtim me dispozitat e vendimit të ri që shprehimisht të miratohet

Shtënim: Vendimi i Këshilli të Bashkisë Pogradec Nr. 133, datë 11.12.2023, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec, është ndryshuar disa here, dhe aktualisht është në fuqi.

2. Për sa më sipër, u hartuan dhe u dorëzuan vendimet shoqëritarë me dokumentacionin përkatës tek Këshilli i Bashkisë, dhe gjatë mbledhjes nga ana e Këshilltarëve, konstatohet se janë propozuar disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

- *Z. Haxhillari, ka propozuar që Segmenti i Rrugës Industriale, të rikthehet përseer me një kalim, me ka që me më përpara dhe jo të shtohen parkime me pagesë.*
- *Zn. Mlanjola Kamolli, ka kërkuar që të jenë bashkëngjitur harta e zonave 3 dhe 4*
- *Znj. Topa ka kërkuar rishikimin e politikës së kartës së rezidentit*
- Në përgjithësi, të gjithë Këshilltarët diskutues në mbledhje kanë qëndër kundër rritjes së tarifës së parkimit për biznesin dhe Z. Shtupa ka propozuar që, *"Për të shmangur rritjen e madhe, parkimet të mos jenë 24 orëshe, por 8 orëshe ose 12 orëshe, përveç hoteleve, në mënyrë që me pas të shfrytëzohen edhe nga qytetarët".*

Për sa më sipër, si dhe pasi u hartatqova me: shkrorjën "a" të pikës 1 të nenit 81 të Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me qëllim përvektimin e politikave tregtare të shoqërisë,

VENDOSA:

1. Të rishqyrtoj paraprakisht (miratimin në parim) të tarifave të parkimeve që do të aplikojë shoqëria POGRADEC INVEST SHTPK, për vitin 2026, duke u bërë disa ndryshime dhe shtesa, duke u anifikuar Vendimi i mëparshëm si më poshtë vijon:

1.1 Tarifë e parkimit tek ish – Terminali

NR	EMËRTESA E TARIFËS	NJËSIA	VLERA E TARIFËS	
			ISHTE	BËHET
1	Tarifë për parkimin e automjeteve në Ish - Terminali	Lekë/orë	50	100

1.2 Tarifa e parkimeve në parkimet publike në pronësi të Bashkisë Pogradec:

NR	EMËRTESA E TARIFËS	NJËSIA	VLERA E TARIFËS			
			ISHTE	BËHET		
1	Tarifa për automjetet në parkimet publike me pagesë, në pronësi të bashkisë Pogradec	Lekë/orë	50	50		
2	Tarifa për automjetet në parkimet publike me pagesë, gjatë sezonit turistik 15 Qershor – 15 Shtator, përgjatë Bulevardit, “Reshit Collaku” dhe “10 Dëshmorët e Pojskës”.	Lekë/orë	50	100		
3	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjektet tregtare pranë biznesit të vet.	Lekë/vit	36 000	8 orë	12 orë	24 orë
				(8:00 - 16:00)	(8:00 – 20:00)	(00:00- 24:00)
				36 000	45 000	72000
4	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjektet tregtare me objekt veprimtarie, “Hotel”.	Lekë/ Vit	36 000	72 000		
5	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për banorët pranë shtëpisë së vet.	Lekë/3 muaj	0	9 000		
		Lekë/6 muaj	0	18 000		
		Lekë/12 muaj	0	36 000		
6	Tarifë për parkim për banorët, për parkim të automjetit brenda zonën së vet ku jeton.	Lekë/12 muaj	1000	1000		

2. Të miratoj në parim dhe paraprakisht kerkesave të mëposhtme:
- Aksi i Zonës Industriale, të behet parkim me pagesë deri në momentin e kthimit të këtij aksi me dy kalime.
 - Përvec dy zonave të miratuara për parkim 1, dhe 2, të shtohet edhe dy zona te tjera në qytetin e Pogradecit 3, 4 në të cilat të behej vijeziimi i parkimeve, vendosja e tabelave dhe të shërbejnë si zona parkimi për rezidentët, sipas hartave bashkëngjitur Vendimit të Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim shërben vetëm për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe i shtrin efektet e veta tregtare dhe financiare pasi të miratohet edhe nga Këshilli i Bashkisë Pogradec, në respektim të shkronjës "f" të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ku sanksion se Këshilli i Bashkisë, vendos për taksat e tarifave vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
4. Ngarkohet administratori dhe administrata e shoqërisë për ndjekjen e procedurës ligjore për dorëzimin e çdo dokumentacioni të nevojshëm për në Këshillin e Bashkisë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI I BASHKISË POGRADEC

(NË CILËSINË E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

POGRADECI INVEST SHPK)


ILIR XHAKOLLI





ZONA 4
ZONE REZIDENZIALE

Ark. Mariano
TASELLARI



ZONA 3

ZONA 3
ZONE REZIDENZIALE

Ark. Mariano
TASELLARI

ZONE PARKIMI ME PAGESE RR INDUSTRIALE



ZONE PARKIMI ME PAGESE RR GANI BUTKA



ZONE PARKIMI ME PAGESE RR INDUSTRIALE

